

"ENGINEERING & LEGAL CONSULTING"

RELACION GJEOLOGJIK I SHKOLLES

“Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Nepravishte” Bashkia Libohove është një domosdoshmeri për njesinë administrative, dhe për vetë rendesinë arsimore të këtij institucioni. Kjo shkollë ka qenë ndër institucione arsimore me fluksin më të madh në zonën e Nepravishtes, pasi në të kryejnë studimet disa nxenesit e disa prej fshatrave të zonës. Krijimi i ambjentëve bashkohore, për një arsimim sa më të mirë të nxenesve. Përmiresimin dhe persosjen e kushteve të punës së mesuesve, me qëllim rritjen e cilësisë së mesimdhënis në shkollë me standarte bashkohore.

KARAKTERISTIKA E OBJEKTIT

Ndërtesa ekzistuese e shkollës përbëhet nga 1 objekt, 1 katesh, me sipërfaqe totale 470 m² dhe një ambient të veçuar prej 6 m² që ka si funksion tualete të shkollës, e vendosur mbi një truall me sipërfaqe totale 2200 m². Shkolla 9-vjeçare Nepravishte frekuentohet gjithmone e më pak, për shkak të kushteve të shkollës dhe ambientet janë totalisht të amortizuara dhe shumë të vogla për krijimin e të gjithë ambjentëve të nevojshme për kryerjen e mesimdhënis. Shkolla ekzistuese ka mungesë të klasave për të kryer mesim. Në shkollë mungojnë laboratorët e mirëfilltë dhe mesimdhënia bëhet në klasa të sajura. Shkolla nuk ka palester të mbuluar. Shkolla është tepër e vogël dhe për të plotësuar nevojat e shkollës me klasa dhe me parametra bashkohore është e domosdoshme rikonstruksioni i shkollës. Sipërfaqja e rikonstruksionit është 470 m².

Objekti ekzistues është i amortizuar. Që nga koha e ndërtimit tij i janë bërë ndërhyrje të pjesshme në suvatime. Mbulesa është me çati, e cila është e amortizuar dhe lejon futjen e lageshtirës në ndërtesë. Muret ndahen të ambjentëve dhe perimetral janë me tulla të plota. Suvatimi i brendshëm është i vjetër, i amortizuar, me vlerë dhe e një cilësie të dobët. Pllakat e dyshëmese janë granili të thyera. Ngrohja nuk ekziston dhe me heret ajo bëhet me soba të cilat janë të amortizuara dhe disa oxhake janë bllokuar. Kangjellat metalike të dritareve janë hekura me profil rrethor të pa mirëmbajtura. Tualetet (WC) janë të amortizuara totalisht dhe janë jashtë shkollës, standart i domosdoshëm për tu afruar me direktivat e Bashkimit Europian. Oborret e shkollës janë me balte dhe të pa organizuara. Mungon totalisht sistemi i ngrohjes, furnizimit me ujë, kanalizimit të ujërave të bardha dhe të zeza.

Projektin e rikonstruksionit të shkollës është hartuar duke shfrytëzuar të gjithë ambjentet ekzistuese dhe duke shtuar ambiente të reja nga të dy anët e ndërtesës. Është bërë e mundur të realizohen: mjediset e nevojshme, funksionale duke ndërtuar klasa me parametra optimal.

Në katin e përde janë parashikuar 7-klasa, drejtoria, salla e mesuesve, biblioteka, informatika, tualete për djem dhe vajza.

"ENGINEERING & LEGAL CONSULTING"

Ne shkollë është parashikuar ngrohja qendrore e cila është me kaldaje me djegje me pelet. Ajo është vendosur në katin nëntokë. Gjithashtu janë parashikuar që dritaret të jenë duralumin dopio xham. Çatija do të rikonstruhet totalisht dhe do të shtohet në pjesën e re. Janë parashikuar të gjithë zerrat e rifinitures duke bërë suvatim me fino të gatshme nga brenda dhe suvatim grafiato nga jashtë. Termoizolimi do të realizohet me polisterol me sistem kapot $t=5\text{cm}$ nga të gjitha anët. Shtresat e dyshemese janë rere për nivelim 7cm, lluster çimento 2-3cm, pllake gres porcelanat mad me sipërfaqe të ashpër. Veshja e banjës do të jetë me pllake majolike. Izolimi i banjës do të bëhet mbi shtresën e lluster çimentos me shtresa hidroizolimi me k/katramat 3d $t=4\text{mm}$ e cila do të ngjitet në mure në një lartësi 30-40cm. Pajisjet e tualeteve do të jenë porcelani çilesi e I-re importi. Banjat do të kenë ujë të ngrohtë me boiler të cilat do të bëjnë ato ambiente funksionale. Shkallet do të vishen me mermer dhe plintuset do të jenë prej mermeri. Gjithashtu mermer ka në dyert e jashtme. Davancialet e dritareve janë mermeri me zmuso dhe pikore nga të dy anët. Dyert e jashtme janë të blinduara. Dyert e brendshme janë prej druri pishe çilesi e parë. Dritaret janë me duralumin termoplastik e cila ruan temperaturën e ambientit. Janë rikonstruuar totalisht instalimet elektrike, ndriçimi, rrjetin telefonik, interneti, furnizimin me ujë, kanalizim i ujrave të ndotur dhe ngrohja qendrore. Ambientet e jashtme janë sistemuar me pllaka betoni. Meqenëse shkolla nuk ka palester është menduar që ambienti sportiv të adaptohet në ambientet e jashtme të shkolles. Duke bërë kështu të mundur krijimin e një ambienti sportiv në funksion të nxenesve të shkolles. Ujrat sipërfaqësor janë sistemuar me kunete betoni të cilat mbliqen në puseta shiu dhe derdhen në kolektorin me të afert. Çilesia e materialeve që është parashikuar të përdoren duhet të jetë e lartë sipas niveleve bashkekohore.

**PER SA ME SIPER RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES NUK KA NDERTESE TE RE
PER RRJEDHOJE DHE NUK KA NEVOJE PER STUDIM GJEOLOGJIK.**

Hartoi;

Ing. Blerim BRAJA